



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 39, datë 28.09.2021

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I SKRAPARIT

Z. AJLI ALUSHANI

Këshilli Bashkiak Skrapar, në mbledhjen e datës 28.09.2021, mori në shqyrtim propozimin të Kryetarit të Bashkisë, Z. Adriatik Mema, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 9, “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1/7, gërma “a”, neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, gërma “m”, Ligjin Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, neni 14, 15 pika 1, gërma “a”, pika 2, gërma “b”, neni 16 dhe vijues,

VENDOSI:

1. Dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Skraparit, Z. Ajli Alushani me motivacionin:
“Në vlerësim të lartë të kontributit të tij të shkëlqyer në fushën e mjekësisë, veçanërisht në atë të kardiologjisë në Shqipëri, dimensionit human dhe profesional të dëshmuar në gjithë karrierën e tij të gjatë si mjek kardiolog në shërbimin me përkushtim, pasion, kompetencë të spikatur dhe dashuri ndaj njerëzve në nevojë. Model i mjekut që gjithë jetën e tij e vendosi në shërbim të pacientëve, duke iu dhënë atyre trajtim mjekësor, shpresë dhe kuptimin e jetës. Një personalitet që me punë të palodhur, si mjek dhe si Ministër Shëndetësie u bë i dashur në vendlindjen e tij dhe gjithë Shqipërinë. Përfaqësues i denjë i Skraparit si deputet në kuvendin e Shqipërisë”.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Skrapar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi u miratua me 13 vota pro, vota kundër – s’ka, vota abstenim – s’ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut.



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

